Kuptimi i këtyre fjalëve...

Pranoj — Të thuash: “Unë jam fajtor.”

Besoj — Të jesh i sigurt se Jezusi është e vërteta.

Bibla — E vërteta absolute dhe e shkruar e Perëndisë.

Jeta e përjetshme (Qielli) — Vendi i përsosur ku Perëndia dhe ata që e kanë pranuar Jezusin si Shpëtimtarin e tyre, do të jetojnë përjetë.

Mëkati — Gjithçka që ti mendon, thua apo bën që është kundër Perëndisë. Të mos bësh atë që na thotë Perëndia në Bibël.

Vdekja e përjetshme (Ferri) — Vendi i ndëshkimit dhe i ndarjes së përjetshme nga Perëndia, ku Satani, demonët dhe të pashpëtuarit do të jetojnë përjetë.

Shpëtimtari (Jezusi) — Ai që na shpëton.

I shpëtuar — I çliruar përjetë nga ndëshkimi i mëkatit.

Fal — Të fshish një borxh ose ndëshkim.

Dorëzohem — Të heqësh dorë nga mënyra si ti i bën gjërat.

ZBULUESIT

Copyright 2023 — Appleton Alliance Association

E BESON APO JO?



DASHURIA E PERËNDISË
JETA E PËRJETSHME NË QIELL

Bibla na thotë se Perëndia është i vërtetë...dhe ky Perëndi i vetëm e i vërtetë, Të DO shumë!


Gjoni 3:16

Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetën e përjetshme.

Në Bibël na thuhet se Perëndia ka përgatitur një vend të përsosur për ata që besojnë. Ky vend quhet qiell.

Gjoni 14:2

Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thosha: Po shkoj t'ju përgatis një vend.



E BESON APO JO?

QIELLI

MËKATI

GJAKU I JEZUSIT

I PASTËR

RRITU

RRITU

Kur Perëndia është udhëheqësi i jetës tënde, jeta jote ndryshon përgjithmonë.

Nga t'ia nisësh?



1. Fol me Perëndinë përmes lutjes. Ai dëshiron të të dëgjojë.



2. Lexo Biblën që ta njohësh Atë më shumë.



3. Shko në kishë dhe kalo kohë me të tjerë që besojnë në të vetmin Perëndi të vërtetë.

2 e Pjetrit 3:18

Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht...

Ka diçka që mungon në qiell...

MËKATI

Mëkati është gjithçka që ti mendon, thua apo bën që është kundër Perëndisë (të kopjosh, të mos u bindesh prindërve, të gënjesh apo të vjedhësh). Në Biblë na thuhet se TË GJITHË kanë mëkatuar.

Romakëve 3:23

Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë.

Për shkak se TË GJITHË mëkatojmë, jemi të ndarë nga Perëndia dhe nuk mund të shkojmë në qiell. Ndëshkimi për mëkatin tonë është vdekja e përjetshme.

Romakëve 6:23

Sepse paga e mëkatit është vdekja, por dhurata e Perëndisë është jeta e përjetshme nëpërmjet Krishtit Jezus, Zotit tonë.

POR PRITNI...KA SHPRESË!



E BESON APO JO?

Gjaku i Jezusit

Perëndia të do kaq shumë, saqë dërgoi Birin e Tij të vetëm e të përsosur, Jezusin, që të të shpëtonte nga ndëshkimi për mëkatin tënd. Kjo është një dhuratë FALAS për ty!

Efesianëve 2:8-9

Sepse, me anë të hirit jeni të shpëtuar, nëpërmjet besimit; dhe kjo jo prej jush, por është dhurata e Perëndisë, jo prej veprave, që askush të mos mburret.

Hebrenjve 9:22

...dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë.

Shumë njerëz mendojnë se Jezusi është ende i vdekur, por kjo nuk është e vërtetë. Jezusi vdiq për mëkatin tonë dhe më pas u ringjall, dhe Ai ka fituar mbi vdekjen (1 e Korintasve 15:3-6).

Jezusi vdiq në kryq për TË GJITHA mëkatet e tua. Pyetja është, ...



E BESON APO JO?

I Pastër

Nëse ti...
Pranon se je mëkatar,
Beson në Jezusin, dhe
I kërkon Jezusit të falë mëkatin tënd dhe të udhëheqë jetën tënde... atëherë ndëshkimi për mëkatin tënd do të jetë 100% i falur!

E BESON APO JO?

Nëse e beson, duhet të flasësh me Perëndinë. Një lutje e thjeshtë si kjo, mund ta ndryshojë jetën tënde përgjithmonë:

I dashur Perëndi,
E pranoj që jam një mëkatar dhe kam nevojë për një Shpëtimtar.
Unë besoj se Biri yt i përsosur, Jezusi, vdiq në kryq për të marrë ndëshkimin për mëkatin tim. Të lutem, fal mëkatin tim dhe bëhu udhëheqësi i jetës sime.

Në emrin e Jezusit,
Amen

Veprat 16:31

Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote.

Sapo ta marrësh këtë vendim të madh, jeta jote ndryshon për gjithë përjetësinë!!